



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:286938
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06231066

C.nr.2807/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Edije Sezairi dhe bashkëpunëtori profesional J.N. në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.N. nga Prizreni të cilin me autorizim e përfaqëson i autorizuari A.A. avokat nga Prizreni, kundër të paditurit A.L. nga fshati Komuna e Vitisë, me objekt kontesti për shkak të borxhit, vlera e kontestit **16,090.00 euro**, jashtë seance, me datën **30.09.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M
për shkak të mosbindjes

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.N. nga Prizreni

II. DETYROHET i padituri A.L. nga fshati Komuna e Vitisë, që në emër të borxhit, t'i paguajë paditësit shumë prej 16,090.00 euro, me kamatë vjetore e cila llogaritet për mjetet e afatizuara mbi 1 vit në bankat komerciale në Kosovë, duke filluar nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 308.00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi M.N. ka parashtruar padi pranë kësaj gjykate kundër të paditurit A.L. nga fshati Komuna e Vitisë, për shkak të kthimit të borxhit, vlera e kontestit 16,090.00 euro.

Me aktvendimin C.nr.2827/2021 datë 28.07.2023, të marr në bazë të nenit 394 të LPK-së, gjykata e ka obliguar të paditurin që në afat prej 15 ditësh nga dorëzimi i padisë me të gjitha provat materiale, të paraqes përgjigje në padi në formë të shkruar në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën paditëse, nën kërcënim të pasojave procedurale. Këtë aktvendim i padituri e ka pranuar me datë 09.03.2023, mirëpo deri në marrjen e këtij aktgjykimi i njëjti nuk i ka dorëzuar gjykatës përgjigje me shkrim në padi.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së e cila parasheh: “*se të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për dhënien e përgjigjes në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht*”.

Numri i lëndës: 2021:286938

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06231066

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 451.1 të LPK-së, ku i padituri është obliguar të paguaj shumën prej 308,00 euro (për padinë dhe taksën gjyqësore të paguar nga paditësi).

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil
C.nr.2807/21 datë 30.09.2024

Gjyqtarja
Edije Sezairi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas pranimit të të njëjtit, në Gjykatën së Apelit në Prishtinë, ndërsa ankesa dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.